



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

PËR: Deputetët e Kuvendit
Cc: Kryesinë e Kuvendit

NGA: Komisioni për Buxhet dhe Financa

LËNDA: Raport me rekomandim, në lidhje me Projektligjin nr.06/L-143 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG, si huadhënës, lidhur me financimin e Projektit për ndërtimin e sistemit të furnizimit me ujë për Komunën e Graçanicës

Nr. 11, datë: 21.01.2019

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bazë të nenit 60 dhe nenit 69, paragrafi 5 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 21.1.2019, shqyrtoi Projektligjin nr.06/L-143 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG, si huadhënës lidhur me financimin e Projektit për ndërtimin e sistemit të furnizimit me ujë për Komunën e Graçanicë dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Projektligji nr.06/L-143 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG, si huadhënës, lidhur me financimin e Projektit për ndërtimin e sistemit të furnizimit me ujë për Komunën e Graçanicës, me amendamentin si vijon:

Amendamenti 1

Titulli i projektligjit, ndryshohet me tekstin si vijon:

“Ligj për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes Republikës së Kosovës, si huamarrës dhe Unicredit Bank Austria AG, si huadhënës, lidhur me financimin e Projektit për ndërtimin e sistemit të furnizimit të ujësjellësit për Komunën e Graçanicës”.

2. Arsyetimin e raportit me rekomandime e paraqet deputeti, Lumir Abdixhiku, kryetar i komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 10, paragrafit 1.4 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me votat e dy të tretave të të gjithë deputetëve, me ligj ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për marrjen e obligimeve financiare nga Republika e Kosovës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 21.1.2019, shqyrtoi Projektligjin nr.06/L-143 për Marrëveshjen për kreditë në mes Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG, si huadhënës, lidhur me financimin e Projektit të ndërtimit dhe përmirësimit të sistemit të ujësjellësit në Komunën e Graçanicës dhe i rekomandon Kuvendit ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Amendamenti i propozuar është i natyrës teknike dhe ka për qëllim harmonizimin e titullit të projektligjit me titullin e marrëveshjes.

**Kryetari i komisionit,
Lumir Abdixhiku**